

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Ishje / Izlazne: Date / Dana: 21 / 06 / 2024		
Nr. Orgv. Org. jed: 01	Nr. Prot. Br. Prot.: 145	Nr. Faqeve. Br. Strana: 2
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT  
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA  
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002  
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net  
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

## Procesverbal nga konsultimi publik për Projekt-Strategjinë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Ferizajt për vitin 2024-2029 si dhe Draft -Planin e Veprimit për Rininë 2024-2027

Me datën 14 Qershor, në Galerinë e Arteve në Ferizaj, është mbajtur konsultim publik për Projekt-Strategjinë e Zhvillimit dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Ferizajt për vitin 2024-2029 si dhe Draft -Planin e Veprimit për Rininë 2024-2027.

Në këtë konsultim publik kanë marrë pjesë të rinjë nga shoqëria civile dhe mediat.

Në hapjen e këtij konsultimi publik drejtorja e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit Xhemile Murati-Shabani, ka thënë se ky dokument është pjesë e projektit "Angazhimi i të Rinjve, një Zë për Ndikim", i financuar nga Departamenti i Shtetit të SHBA-së përmes programit "Alumni Engagement Innovation Fund 2023", mbështetur nga Ambasada e SHBA-së në Kosovë, administruar nga KUSA dhe zbatuar nga dy anëtarë të Alumni, në bashkëpunim me Organizatën Qendra për Avokim dhe Angazhim Qytetarë AdVOICE.

"Strategjia e Rinisë për Komunën e Ferizajt, vjen si domosdo e kohës, për të orientuar me saktësi, të shtrirë në kohë e me objektiva të qarta, vizionin tonë për të rinjtë", ka thënë drejtorja e kulturës.

Plani i Veprimit 2024 - 2027 është realizuar me përkrahjen e projektit "Mbështetja e të rinjve/ të rejave nga komunitetet pakicë me aktivitete psiko-sociale, emocionale si dhe fuqizimi, integrimi i tyre në aktivitete kulturore në Rajonin e Ferizajt, faza e dytë." Ky projekt është financuar nga iniciativa 'Komuna për të rinjtë,' e cila mbështetet nga Qeveria e Japonisë përmes Fondit Japonez për Zhvillim Social, të administruar nga Banka Botërore dhe implementuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT  
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA  
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002  
E-mail: [info.ferizaj@rks-gov.net](mailto:info.ferizaj@rks-gov.net)  
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

bashkëpunim me Fondin e Zhvillimit të Komunitetit (CDF), dhe participuar financiarisht nga Komuna e Ferizajt.

Të pranishmit në këtë konsultim publik nuk kanë dhënë asnjë sugjerim dhe kërkesë për inkorporim në këtë strategji dhe plan.

Ky konsultim publik ka përfunduar në orën 11:00.

Procesmbajtëse

Shyhrete Topalli